



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA E QYTETIT  
KORÇË

**VENDIM**

Nr. 18 Datë 27.10.2008

Mbi një ndryshim në Strukturën  
dhe pagat e Administratës së Ndërmarrjes Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve

Këshilli Bashkiak Korçë , i mbledhur sot në datë 27.10.08 , pasi mori në shqyrtim propozimin e Ndërmarrjes Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve , mbështetur në ligjin nr.8652 datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore" neni 32 , gërma ç , ligjin nr.10025 datë 27.11.2008 "Për Buxhetin e vitit 2009" , Udhëzimin nr.2 datë 12.01.2009 "Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2009" , ligjin 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr.1619 datë 02.07.2008 "Për klasifikimin e funksioneve , grupimin e njësive të të qeverisjes vendore , për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore" dhe V.K.B nr.2 datë 12.02.2008 , V.K.B. nr.14 datë 18.03.2008 si dhe V.K.B. nr.93 datë 19.09.2008 , vendosi ;

1. Të miratoje ndryshimin e strukturës së Ndërmarrjes Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve , dhe konkretisht :

- Pakësimin e 1 ( një ) specialisti të nivelit të mesëm , dhe
- Shtimin e 1 ( një ) specialisti të nivelit të lartë .

Ndryshimet në strukturë do të jenë :

Nr	Emërtimi	Nr. i punonjësve	Kategori a	Paga e grupit	Shtesa për pozicion	Kategori fikse
3	Specialist i nivelit të lartë	3	III.b	12000	25124	
5	Specialist i nivelit të mesëm	1	P18			28310

2. Efektet financiare të këtij ndryshimi të fillojnë me menjëherë.
3. Efektet financiare të këtij ndryshimi , për vitin 2009 do të përballohen nga ana e Ndërmarrjes Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve , pa kërkuar shtesë fondi në artikullin 600 ( Paga ) .
4. Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi Ndërmarrja Mbështetëse e Arsimit dhe Çerdheve

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**

**Gjergji PENDAVINJI**